



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_925_04_13**;
- Ankesa e KEK-ut e datës 08.05.2013

në seancën e mbajtur më datë 28 qershor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N.M., (shifra e konsumatorit: DPR – 90040604) nga fshati Mazgit i Ulët, Kastriot ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_925_04_13 i datës 17.04.2013.

Arsyetim

Departamenti i Faturimit në KEK në muajin 10/2010 e ka faturuar konsumatorin me faturë të energjisë elektrike si faturë mujore prej 4638 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 468.57€.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 22.10.2010 kanë dalur te konsumatori N.M. me shifër DPR – 90040604 dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 200270 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik të KEK-ut nr. 4694894. Po ashtu punëtorët e autorizuar të KEK-ut në procesverbalin nr. 0585808 të datës 22.10.2010 kanë bërë inspektimin e kësaj pike matëse dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se njehsori 200270 duhet të shkoj në kalibrim për verifikim pasi që nuk bënë matje të saktë.

Punëtorët e autorizuar të Qendrës së Kalibrimit në KEK me datë 09.12.2010 kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 200270 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes.

Me datë 28.10.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur te konsumatori N.M. me shifër DPR - 90040604 dhe kanë bërë inspektimin e kësaj pike matëse dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se konsumatori është bërë bllobimi në "KPO".

Pas kësaj konsumatori me datë 10.11.2010 ka kundërshtuar faturën e muajit 10/2010 pasi sipas konsumatorit ai nuk i ka shpenzuar gjithë këta kilovat. Departamenti për Konsumator në KEK i është



përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit bazuar në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 012181 të datës 09.12.2010.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 17.04.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: 1) të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR - 90040604 nga fatura 101090297DPR-90040604 e datës 04.11.2010 në vlerë financiare 468.57€; dhe 2) të ngarkoj konsumatorin për periudhën 09/2010 bazuar në shpenzimin e njëjtë të muajit 09/2009 e cila ka qenë TL=110 kWh dhe TU=310 kWh apo në total prej 420 kWh me çmime të muajve të sezonës së lartë (dimrit).

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 08.05.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është konstatimi i punëtorëve të KEK-ut në teren për matje jo të saktë të njehsorit nuk qëndrojnë ngase matjen e konstaton qendra e kalibrimit dhe të cilën e ka bërë me datë 09.12.2010. KEK-u menjëherë pas ankesës së konsumatorit ka ndërmarrë veprim dhe me datë 01.03.2013 ka korrigjuar vlerën prej 128.42€.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28 qershor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalet e KEK-ut nr. nr. 0656613 të datës 12.11.2010 dhe nr. 0585808 të datës 22.10.2010 dhe kanë vërejtur se në këto procesverbale punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 200270 nuk bënë matje të sakta dhe se duhet të shkoj në kalibrim për shqyrtim të mëtuajtshëm. Bordi i ZRRE-së po ashtu ka vërejtur se KEK-u me datë 04.11.2010 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike për muajin 10/2010 si shpenzim mujore prej 4638 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 468.57 €. Punëtorët e qendrës së kalibrimit pas ndërrimit të njehsorit elektrik kanë bërë shqyrtimin e njehsorit nr. 200270 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes.

Është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit me shifër DPR – 90040604 dhe është vërejtur se fatura mujore të energjisë elektrike e muajit 10/2010 prej 4638 kWh/muaj nuk është reale, pasi që për të njëjtën periudhë kohore 10/2011 me njehsor të ri elektrik nr. 4694894 shpenzimi i energjisë elektrike është 280 kWh, ndërsa për të njëjtën periudhë kohore një vit më herët 10/2009 me njehsorin nr. 200270 ka shpenzim prej 420 kWh. Po ashtu është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 200270 dhe me njehsorin elektrik nr. 4694894 dhe është vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë prej momentit të vendosjes së njehsorit dixhital nr. 200270 prej periudhës 12/2005 e deri më 09/2010 është 460 kWh, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë e njehsorit elektrik nr. 4694894 prej periudhës 10/2010 e deri më 03/2013.

Sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 200270 TIM Kosova deri në muajin 09/2010 dhe me njehsorin e vet KEK-ut nr. 4694894 vërehet se nuk ka ndryshime, madje shpenzimi i energjisë elektrike është pothuajse i njëjtë, ndërsa vetëm në muajin 10/2010 me njehsorin e elektrik nr. 200270 kemi një shpenzim mujor enorm prej 4368 kWh.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.06.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_925_04_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar